

nr. Prot. 307 dt 22/7/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 2 Datë 15./06/2011

**“Për
miratimin në parim të kërkesës, për shtesë të përdorimit të rezervave ujore nga
përroi I Vlushës në Hidrocentralin ekzistues të Corrovodës , për prodhim
hidroenergjie, Corrovodë, rrethi Skrapar.**

Në mbështetje të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe vendimit nr. 3, datë 19.07.2002 të KJU “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të KJU, Këshillave të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjensive të Ujit”, kreu III, pika 2.8 B, të Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin në parim të kërkesës, për shtesë të përdorimit të rezervave ujore nga përroi I Vlushës, me konçesion, për prodhim hidroenergjie rrethi Skrapar.

HIDROCENTRALI I CORROVODËS

- a-Prurje mesatare e përroit të Vlushës $Q_m=3.1$ m³/sek
- b-Prurje shtesë që kërkohet të merret nga përroi i Vlushës $Q_m=1.1$ m³/sek
- c-Kuota në veprën e marjes 304.1 m

- 1-Sasia e ujit jepet me kushtin që, më parë të plotesohen nevojat për ujë të pijshëm të popullatës pra duhet të rakordojë me Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve Corrovodë.
- 2-Sasia e ujit jepet për përdorim në përputhje me kërkesat në sezonin e vaditjes, rakorduar me çdo vit me Bordin e Kullimit Berat.
- 3-Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Saimir HOXHAI**



KRYETARI I KBU

**SEMAN
Bujar HASAJ**

